

SZKOŁA ÉCOLE

ESCOLA SCUOLA SKOLA

ESCUELA

DIBÎSTAN

SCHOOL

SHKOLLË

CHYO

SOLA



SCHULE



## Të dashur prindër, të dashur kujdestarë!

Mirë se vini në Köln!

Në Gjermani fëmijët nga mosha 6 deri në 16 vjeç duhet të shkojnë në shkollë.

Këtu gjeni informata të rëndësishme!




## Hapi i parë

1. Ju lutem kontaktoni përmes telefonit me Qendrën Komunale për Integrim në numrin: 0221 / 221-29292. Aty do të mund të caktoni terminin për bisedën informative.



**(0221) 221 29292**



2. Në këtë takim duhet të merrni edhe fëmijën tuaj. Në rast se posedoni dëftesa shkollore të fëmijës suaj, ju lutem i sjellni edhe ato me vete.




3. Mundësisht ejani me ndonjë person që flet gjuhën gjermane sadopak. Punonjëset dhe Punonjësit në Qendrën Komunale për Integrim flasin disa gjuhë.




## Në Qendrën komunale për Integrim

4. Punonjësit duan të dinë, kur është i lindur fëmija juaj, çfarë gjuhe flet dhe për sa kohë e ka ndjekur shkollën. Ata gjithashtu do të ju pyesin nëse fëmija juaj tashmë mund të flas gjermanisht apo jo.

Në Köln ka klasa, ku gjuha gjermane mund të mësohet shumë shpejt. Në këtë takim ju do të njoftoheni rreth të gjitha këtyre klasave dhe shkollave.



5. Pastaj Qendra Komunale për Integrim informacionet e mbledhura lidhur me fëmijën tuaj, do ti dërgoj në Zyrën Komunale të Arsimit të Qytetit Köln.




**6.** Në ndërkohë ju do të caktoni një termin në Entin e shëndetësisë. Kjo është shumë me rëndësi, sepse çdo fëmijë duhet të kontrollet para se të filloj shkollimin. Për caktimin e terminit me Entin e shëndetësisë, do të ju ndihmoj Qendra Komunale për Integrim.



**7.** Zyra e Arsimit për Qytetin e Kölnit do të ju dërgoj pastaj një shkresë. Në këtë shkresë, ju do të njoftoheni se në cilën shkollë do të ndjek mësimet fëmija juaj.



**8.** Nëse shkresa nga Zyra e Arsimit ka ardhur te ju dhe fëmija juaj ka vizituar Entin e shëndetësisë, fëmija juaj mund të ndjek mësimet shkollore. Ne i dëshirojmë shumë suksese!




## Përshkrimi i rrugës

Për këshilla ju duhet të caktoni një termin. Ju lutem na kontaktoni përmes telefonit në numrin tonë: 0221/221 29292.

Qendra Komunale për Integrim gjendet në Adresën:  
Rruga: Kleine Sandkaul 5, 50667 Köln

Si mund të na gjeni?

Udhëtoni me tren apo autobus deri te stacioni „Heu-  
markt“. Prej aty ecni kah rruga Pipinstraße në drejtim të  
Neumarkt. Në cep të hotelit Dorint kthehuni djathtas  
në rrugën „Kleine Sandkaul“. ođó «Kleine Sandkaul»





in anderen Sprachen  
in other languages  
en otros langues  
en otros idiomas  
diger dillerde

[www.ki-koeln.de/schule](http://www.ki-koeln.de/schule)



**Stadt Köln**



## Die Oberbürgermeisterin

Kommunales Integrationszentrum  
Amt für Presse- und Öffentlichkeitsarbeit

Gestaltung

Zentrale Dienste der Stadt Köln

Druck

Druckhaus Süd, Köln